



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

**KRYETARI I KRYEQYTETIT**

*M-020/04-18259/23*, më 25 JAN 2023

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, me 28/04, qershor 2008) të nenit 9 dhe 10 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës 01-020/01-194101/18 i dt. 08.08.2018 dhe nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet themelimi i komisionit për shqyrtimin e ankesave lidhur me mbështetjen financiare për viktimat e dhunës në familje.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, komisioni është në këtë përbërje:
  1. Naim Gashi, Qendra për punë sociale, kryesues;
  2. Diellon Gjonbalaj, Sektori Ligjor, anëtar;
  3. Zade Zogjani, Drejtorja e Mirëqenies Sociale, anëtare.
3. Detyrë e komisionit të cekur si në pikën 2 të këtij Vendimi, është shqyrtimi i ankesave dhe vendosja lidhur me të njëjtat sipas kritereve të përcaktuara në Vendimin për përkrahje financiare viktimave të dhunës në familje nr. 01-450/03-257590/22 i dt. 25.11.2022, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.
4. Mandati i komisionit të cekur sipas pikës 2 të këtij Vendimi, është tre (3) vjeçar.
5. Për kryerjen e këtyre detyrave të cekura në pikën 3 të këtij vendimi, komisioni i raporton Kryetarit të Komunës.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**U dorëzohet:**

- Anëtarëve të komisionit;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.



**KRYETARI I KRYEQYTETIT**  
**Përparim Rama**